

albaqeramika

Amfora

Botim i Albaqeramika
Edicioni numër 9
Mars 2016

www.albaqeramika.com

Gruaja, rol vendimtar në zhvillim të biznesit



Nga: Mijesere Deçani

Roli i gruas në shoqëri ka qenë një temë e shpeshtë në dekadat e fundit. Për shkak të këtij afirmimi, pa dyshim, gruaja edhe ka arritur të konsolidohet në rolin e saj në shoqëri

duke pasur parasysh paragjykimet e mëhershme, kur është konsideruar kryesisht vetëm si mbajtëse e shtëpisë dhe kujdestare e fëmijëve.

Jemi të vetëdijshëm se barazia gjinore në kohët tona as që do të duhej të ishte temë diskutimesh. Kjo në një shoqëri normale do të duhej të ishte e vetëkuptueshme, prandaj unë do të ndalem më shumë tek të mirat që sjell angazhimi i gruas në biznes. Përderisa burrat për shkak të natyrës prej gjuetari janë më shumë të dhënë kah rezultatet financiare, gratë kanë zell më të madh për përkujdesje, veçanërisht për ofertën dhe shërbimin, kontaktin me klientin.

Dhe është më se e sigurtë se një mori klientësh të kënaqur me shërbimin është predispozitë e suksesit të një biznesi. Është, pra,

edhe predispozitë e drejtpërdrejtë e përcaktimit të rezultateve financiare. Mendimi i gruas në një tavolinë diskutimi rreth strategjisë së biznesit është vendimtar për t'i dhënë një formë fitimtare planeve të secilës kompani.

Ne në ALBA Qeramika gjithmonë jemi kujdesur që të punësojmë sa më shumë gra që është e mundur. Sot në sallonet tona do të shihni se gjysma e të punësuarve janë të gjinisë femërore.

A ia kemi qëlluar?

Besoj se rezultatet e arritura nga ALBA Qeramika, si lidere në sektor, flasin vetë.

Andaj, më lejoni ta shfrytëzoj këtë rast që të gjitha grave, e sidomos atyre të angazhuara në biznes, t'ua uroj festën e tyre të shtrenjtë - Urime 8 Marsi!

Ju mirëpresim!



Diana Meraku është menaxhere e shitjes së sanitarisë në Albaqeramika. Ajo thotë se gjithmonë e fillon ditën me idenë për të punuar me korrektësi dhe përgjegjësi të plotë për të arritur synimet e planifikuara ditore. Duke qenë menaxhere në një kompani të madhe të qeramikës, ku gjatë ditës parakalojnë me qindra klientë, domosdo se Diana përballë me situata të ndërlikuara, por këto ajo i quan ndryshe.

“Vështirësitë apo sfidat nuk i quaj probleme, por gjithmonë i konsideroj

Menaxhimi është vullnet personal, e jo gjinor

situata apo mundësi për t’iu gjetur zgjidhje. Kur ndodh diçka e papritur, mënyra e qasjes është që ta shikoj origjinën e shkakut dhe përmes kësaj ta gjej zgjidhjen e problemit”, thotë ajo.

Për t’i zgjidhur këto formula, Diana thotë se është esencjal kultivimi i marrëdhënieve të mira me stafin, sepse, siç thotë, duke iu falënderuar atyre sot është pjesë e një kompanie të suksesshme.

Për të arritur rezultate në menaxhim, ajo thotë se duhet edhe durim, ndërsa si veçori të saja kryesore si menaxhere ajo e konsideron sigurinë në vendimarrje, e hapur përballë situatave të ndryshme dhe strategji

në punë.

Sa i përket suksesit ekipor, sipas menaxheres së ALBA Qeramikës në Prishtinë, esenciale është që stafi të ketë qëllime të përbashkëta si dhe harmonizim të qëllimeve personale dhe atyre të kompanisë.

Diana dëshiron t’i motivojë të gjitha femrat që ta provojnë veten në menaxhim, sepse jo rrallë herë ato janë treguar të suksesshme në udhëheqje.

E pyetur nëse ka dallim mes një menaxheri dhe menaxhereje ajo ka një përgjigje interesante.

“Aftësia për të menaxhuar një organizatë është e përcaktuar nga dëshira dhe motivi personal e jo gjinor”.

ALBA Qeramika në “CEVISAMA 2016” dhe “UNICERA 2016”



Përfaqësuesit e kompanisë ALBA Qeramika, prej datës 1 e deri më 3 shkurt, edhe sivej kanë vizituar panairin ndërkombëtar të pllakave dhe produkteve sanitare “CEVISAMA 2015”, në Valencia të Spanjës. Të pranishëm në këtë panair ishin Valdet Deçani, Fisnik Deçani dhe Fisnik Daci, të cilët u shprehën mjaft

të kënaqur, për faktin se ky panair sjellë shumë risi në lëmin e caktuar.

“Vizitat e ALBA Qeramikës në panairë bëhen me qëllim që vazhdimisht të jemi në trend me zhvillimet e reja në fushën e qeramikës dhe sanitarisë. Ky është edhe një obligim që kemi para konsumatorëve tanë”, tha Valdet Deçani, partner menaxhues i kompanisë.

Gjithashtu, nga data 22 deri më 25 shkurt, përfaqësuesit e ALBA Qeramika kanë vizituar panairin ndërkombëtar të sanitarisë dhe produkteve të pllakave “UNICERA 2016” në Stamboll të Turqisë.

Të pranishëm në këtë panair ishin Senad Krasniqi, Granit Sheremeti, Armend Krasniqi edhe

Fisnik Daci.

Gjatë panairit, ata patën takime të shumta me prodhues të ndryshëm, me ç’rast me disa prej tyre kanë arritur të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për produkte të reja që shumë shpejt do të paraqiten në sallonet e ALBA Qeramikës.

“Besojmë se këto marrëveshje të reja do të risin edhe më tutje cilësinë e ofertës sonë”, u shpreh zv.drejtori Sheremeti.

Panairët e ndryshme që vizitohen nga ALBA Qeramika, gjithmonë premtojnë bashkëpunime të reja, frymë të re në kompani, si dhe mundësi të shumta përzgjedhesh për klientët.

Panairi “Cevisama” është i përvitshëm dhe është i dyti për nga madhësia në Evropë, pas panairit “Cersaie” të Bolonjës.

Risi në ALBA Qeramika

Bashkëpunimi i ri i ALBA Qeramikës me “Royo Group” nga Spanja.

“Royo Group” është njëri prej grupacioneve më të mëdha në sferën e prodhimit të mobiljeve të banjës në Spanjë.

Më poshtë mund të shihni disa produkte të kësaj kompanie që mund t’i gjeni tek ne.



BRENTA

Dushi Brenta ofron një set origjinal dyngjyrësh (të zeze dhe të bardhë). Brentan e përcakton kontrasti, lakimet e buta dhe seti termostatik i përbërë edhe nga dy rrjedhje lëvizëse masazhi.



ROUND

Round është një koleksion shumë funksional që ofron hapësira të mjaftueshme për vendosjen e peshqirave dhe gjësendeve tjera të nevojshme në banjo. Me forma të rrumbullakëta dhe me finishe të rafinuara, koleksioni Round krijon ndejnjën e rehatisë dhe relaksit.



GALAXY

Lavamani Galaxy ka formë ovale me ngjyrë të bardhë, një dizajn modern dhe shumë bashkëkohor. Idea e kreatorëve ka qenë që të ofrojnë një produkt unik për banjën tuaj. Një produkt që i shton finisë artistike ambientit.

ALBA Qeramika ka sjellë edhe pllaka të reja me dimensione 180x60cm nga prodhuesi i famshëm i pllakave në Itali, “Cooperative Ceramica d’Imola”, por edhe risi tjera nga [Lafaenza](#).

LOJA SHPËRBLYESE NË FACEBOOK



KUNI

Bukuria e Kuni-t qëndron në dukjen magjepsëse dhe jashtëzakonisht të ngrohtë të drurit të përzier me ngjyra reale dhe natyrore. Një dukje “e egër”, së cilës i është dhënë zgjidhje bashkëkohore nga formati më i ri me dimensione të mëdha prej 60x180 cm, i cili më parë nuk ka qenë i disponueshëm në treg.

NIRVANA

Magjia e natyrës dhe aftësia e saj për të krijuar dhe për të ndryshuar elementet kompozicionale ishte frymëzimi i krijimit të pllakave Nirvana. Koncepti krijues filloi me idenë e drurit të tharë nga dielli. Nirvana është në dispozicion në 3 formate: 60x180 cm, 20x180 cm dhe 20x120 cm.



Qëndrim F. Shala dhe Azem A. Berisha janë dy fituesit e garës për foto me ambiente dhe produkte të ALBA Qeramika. Fotot e Qëndrimit dhe të Azemit kanë marrë më së shumti pëlqime dhe shpërndarje në Facebook, kushti ky i vetëm i garës. ALBA Qeramika do të vazhdojë të ketë prapë lojë shpërblyese për klientët e saj.

Majlinda Kelmendi nxit ëndërrat sportive të nxënësve

Kampionia e botës në xhudo, Majlinda Kelmendi, në fillim të muajit mars ka vizituar disa shkolla të qytetit të Pejës dhe të Prizrenit, si pjesë e aktiviteteve të përkrahura nga ALBA Qeramika me qëllim rritjen e vetëdijes për rëndësinë e sportit të femijët.

Në këto takime Majlinda ka bashkëbiseduar me fëmijë dhe ka treguar për hapat e saj të parë në këtë sport. Ajo gjithashtu ka demonstruar disa “truqe” të xhudos dhe u është përgjigjur pyetjeve të shumta të fëmijëve. “Kemi rini të shëndoshë dhe të etur për të mësuar teknika sportive. Sa herë që takoj fëmijë që më thonë se duan të bëhen kampionë në ndonjë lëmi sportive më kujtohet dëshira ime e

njëjtë në moshën e tyre”, shprehet Majlinda. “Porosia ime për ta është – me punë arrihet çdo gjë”.

Fëmijët nuk kanë fshehur gëzimin për takimin me kampionen e botës dhe kishin përgatitur shumë surpriza për të. Gëzimin e tyre fëmijët kishin vendosur ta shprehin përmes disa këngëve, poezive dhe një posteri që e mirëpriste kampionen me fjalët “krenohemi me ty”.

Ndër të tjera, Majlinda falënderoi ALBA Qeramikën për mundësimin e këtij takimi me nxënësit anembanë Kosovës, me shpresë që sado pak këto vizita t’i nxisin ata për të punuar në drejtim të ëndrrave të tyre sportive. “Sporti është një nga mënyrat më të

mira për zhvillimin e mendjes dhe trupit”, tha ajo.

Gjatë dhjetorit të vitit të kaluar, Majlinda e përkrahur nga ALBA Qeramika, kishte vizituar edhe shkollat e Prishtinës. Një nga synimet e ALBA Qeramikës në drejtim të kontributit për shoqërinë është edhe afirmimi dhe mbështetja e sportit kosovar, ku kjo kompani ka përkrahur ekipe dhe sportistë në disa fusha si basketbolli, xhudo, shahu etj. Ndër të tjera, ALBA Qeramika është sponsore e dy prej ekipeve më të mira basketbollistike në Kosovë, KB Peja dhe KB Prishtina.



Fakte interesante për qeramikën

- Fjala qeramikë vjen nga një fjalë e lashtë greke “keramikos” që paraqet poçarinë.
- Qeramika krijohet nga flakërimi (ngrohja) e argjilës në furra të temperaturave të larta.
- Disa qeramika nuk shkrihen deri në arritjen e një temperature prej 3.997 ° C.
- Qeramikat më të vjetra të bëra nga dora e njeriut datojnë të paktën 24,000 vjet para erës sonë dhe u gjetën në trevat e Çekisë dhe Sllovakisë.
- Disa zëvendësime ortopedike të ijeve kanë protezë qeramike. Komponenti mineral natyral i kockave, është bërë në mënyrë sintetike nga një numër i burimeve biologjike dhe kimike dhe mund të formohet në

materiale qeramike. Implantet ortopedike të ndërtuara nga këto materiale lidhen lehtë me kocka dhe inde të tjera në trup, pa refuzim ose reaksione inflamatore.



- Kurorat dentare janë të bëra nga qeramika.
- Kompjuterët kanë përbërës prej qeramike, siç janë izolatorët, rezistorët, superpërcjellësit, kapacitorët dhe paketimet mikroelektronike.
- Frenat e diskut në shumicën e automjeteve moderne janë të punuara nga materiale qeramike.
- Qeramika gjen përdorim të gjërë në jetën e përditshme, si në tulla, pllaka dyshemeje, pllaka muri, qelqi, tjegulla, frena qeramike të automobilave e tuba sanitare.



www.facebook.com/albaqeramika



twitter.com/ALBAQeramika



www.instagram.com/albaqeramika



+377 45 60 29 99 Prishtinë
+386 49 20 50 50 Pejë
+386 49 21 80 80 Prizren

Në Alba Qeramika mund të paguani edhe me POS të këtyre bankave:



ALBA Qeramika, km IV, magjistralja Prishtinë-Ferizaj 10000 Prishtinë
0038649206060
office@albaqeramika.com

Implementuar nga PROCON